



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Monitoruesi i Korrupsionit

Raport mbi Aktivitetet e Institucioneve Përgjegjëse për Luftimin
dhe Parandalimin e Korrupsionit

Janar-Dhjetor 2012

Mars, 2013

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	4
Hyrje	6
Qeveria e Kosovës	8
Kuvendi i Kosovës	9
Statistikat e prokurorive në luftë kundër korrupsionit	10
Sistemi Gjyqësor i Kosovë	11
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	12
Policia e Kosovës	13
Agjencia Kundër Korrupsionit	14
Raportet Ndërkombëtare	16
Raporti i Fizibilitetit	16
Transparency International	17
Freedom House	18
Raportet nga Shoqëria Civile	18
Falënderime	21
Rreth Lëvizjes FOL!	21

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

DHKEK - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

FH - Freedom House

KDI - Kosovo Democratic Institute (Instituti Demokratik i Kosovës)

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës

PDK - Partia Demokratike e Kosovës

PK - Policia e Kosovës

SPVKK - Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit

TI - Transparency International

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport politikash dëshmon mungesën absolute të seriozitetit të institucioneve publike për ta parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Të gjeturat e këtij raporti argumentojnë se institucionet përgjegjëse për luftimin e korrupsionit nuk kanë ndërmarrë masa të mjaftueshme dhe të nevojshme për ta reduktuar nivelin e lartë të korrupsionit në institucionet publike.

Qeveria e Kosovës përgjatë vitit 2012 ka nxjerrë 404 vendime gjithsej. Prej këtyre vendimeve vetëm 5 kanë qenë në luftë kundër korrupsionit: a) miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion për vitin 2013-2017; b) themelimi i Komisionit Ekzekutiv (në të cilën përfshihen Politikat Anti-Korrupsion dhe Gjyqësori); c) shkarkimi i dy anëtarëve të bordeve, njëri anëtar i Bordit të Drejtorëve të KUR “Hidrodrini”, SH.A. Pejë, si dhe tjetri anëtar i bordit të drejtorëve në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK); d) miratimi i projektligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale; f) miratimi i dy koncept dokumenteve: hartimi i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë, si dhe hartimin e projektligjit për plotësim- ndryshimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kuvendi i Kosovës përgjatë vitit 2012 ka mbajtur gjithsej 47 seanca plenare. Në 6 mujorin e parë të këtij viti Kuvendi vetëm në dy seanca i ka dhënë hapësirë diskutimit të fushës anti korrupsion, edhe atë duke diskutuar për Strategjinë Kundër Korrupsion dhe Planin e Veprimit 2013-2017 dhe për Raportin Vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsion (2011). Ndërkaq e tëra çfarë ka bërë në gjashtë mujorin e fundit është shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale.

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK), e cila vepron në kuadër të Policisë së Kosovës, rezulton që gjatë viti 2012 janë kryer hetime ndaj 157 personave, 56 janë arrestuar, 129 janë dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, 1 rast është dërguar në prokurori me N/N dhe 19 raste të tjera janë dërguar me raport të Prokurorit.

Gjykatat e rregullta komunale të Kosovës kanë trashëguar nga vitet paraprake gjithsej 197 lëndë. Po këto gjykata gjatë gjithë vitit 2012 kanë pranuar në punë gjithsej 169 lëndë, ndërkaq si lëndë në punë që janë në proces të shqyrtimit janë gjithsej 366. Gjykatat e rregullta komunale gjatë 2012 kanë zgjidhur gjithsej 148 lëndë. Ndërkaq, në fund të periudhës raportuese, kanë mbetur gjithsej 218 lëndë të pazgjidhura.

Sipas statistikave të prokurorisë, të ndërlidhura me fushën anti-korrupsion, rezulton që ato kanë trashëguar nga vitet e mëparshme gjithsej 802 lëndë. Gjatë po kësaj periudhe 1 vjeçare janë pranuar 376 lëndë të reja. Janë ngritur 140 propozim-akuza dhe 132 aktakuza. Rastet e zgjidhura sipas numrit të personave janë 770, ndërsa kanë mbetur pa u zgjidhur rreth 990 lëndë. Në fund të periudhës raportuese kanë mbetur pa u zgjidhur 265 kallëzime penale.

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) gjatë vitit 2012 ka qenë kryesisht e fokusuar në tre aktivitete në luftë kundër korrupsionit. Është marrë me deklarinimin e pasurisë, si njëri nga obligimet kryesore ligjore të zyrtarëve të lartë publikë, ku sipas AKK gjatë vitit 2012 e kanë përmbushur 91.71% e tyre. Ka shqyrtuar një numër të rasteve të konfliktit të interesit, si dhe ka nxjerrë një analizë mbi ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit në Kosovë.

Hyrje

Korrupsioni dhe krimi i organizuar vazhdojnë të paraqesin kërcënimin kryesor për sundimin e ligjit në Kosovë. Krahas pamundësisë së shtrirjes së sovranitetit në të gjithë territorin e saj, dhe kërcënimit që paraqet ky aspekt për sigurinë dhe konsolidimin e ligjit, korrupsioni dhe krimi i organizuar janë dy shtyllat kryesore që pengojnë procesin e shpejtë dhe të drejtë të liberalizimit të vizave. Viti 2012 është karakterizuar me skandale nga më të rëndat, siç ishte ai me pasaportat biometrike, ku zyrtarët e lartë publikë u shndërruan në protagonistë kryesorë.

Gjatë vitit 2012 Kosova ka shënuar përparim të pjesshëm në përmirësimin e kuadrit ligjor kundër korrupsionit, por në të njëjtën kohë ka vërejtur edhe një regres në përpilimin e dokumenteve strategjike kundër korrupsionit, si dhe rregullimit të fushës së konfiskimit të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.

Në njërin anë, kuadri ligjor mbi të cilin edhe funksionon Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) ka shënuar një përmirësim të theksuar në çështjet e rregullimit të zbrazëtirave të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit. Tashmë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës ‘deklarimi i rrejshëm’, ‘refuzimi i deklarimit’ dhe ‘konflikti i interesit’ janë kategori juridike dhe si të tilla sanksionojnë këto çështje në aspektin penal.

Duke qenë se të metat më të mëdha në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, brenda fushëveprimit të mandatit të AKK-së, kanë qenë mungesa e penalizimit të ‘deklarimi i rrejshëm’, ‘refuzimi i deklarimit’, si dhe ‘konflikti i interesit’, futja e këtyre kategorive në Kodin e ri Penal do ta konsolidojë dhe qartësojë relativisht mirë këtë fushë. Për më shumë, këto përmirësime të kuadrit ligjor kundër korrupsionit do ta bëjnë AKK-në më efektive dhe me rezultate më të prekshme kundër korrupsionit.

Krahas këtij përmirësimi të kuadrit ligjor kundër korrupsionit, ka pasur një rrjedhë tjetër e cila, bazuar në vlerësimet e shoqërisë

civile, nuk do të jap efektin e synuar. Kosovës, bazuar edhe në Dokumentin Punues të Stafit të Komisionit Evropian për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, i kërkohet aprovimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në shkurt të 2013, vetëm një ditë para se raportuesja për Kosovën, Ulricke Lunachek të vijë në Kosovë, miraton Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit, një dokument të përpiluar nga AKK-ja, përkundër vërejtjeve thelbësore që shoqëria civile i ka dhënë për të.¹ Po ashtu, këtë ditë Kuvendi i Kosovës ka miratuar edhe ligjin për konfiskimin e pasurive të paligjshme, për të cilin shoqëria civile thotë që nuk do t'i jap asnjë efekt real në terren.

Ashtu sikur edhe herëve tjera, këto ndryshime të kuadrit ligjor kanë ardhur si kusht i vendosur nga bashkësia ndërkombëtare dhe kanë qenë të lidhura me procesin e liberalizimit të vizave. Në Dokumentin Punues të Stafit të Komisionit Evropian për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, shprehimisht ceket që aprovimi i këtyre dokumenteve dhe përmirësimit të ligjeve është esencial në rrugën e Kosovës drejt BE-së.


Sidoqoftë, krahas një përmirësimi të kuadrit ligjor kundër korrupsionit, Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit, por edhe ligji për konfiskimin e pasurisë, nuk priten të japin ndonjë efekt pozitiv të prekshëm. Në një aspekt, kjo tregon që edhe bashkësia ndërkombëtare nuk ka qenë shumë e vendosur rreth kualitetit të Strategjisë dhe Ligjit të konfiskimit të pasurisë, por është mjaftuar vetëm me aprovim simbolik të tyre.

¹ Koha.net. (2012, Shkurt 11). "Me gjithë vërejtjet, miratohet strategjia antikorrupsion". <http://www.kohaditore.com/?page=1,13,134581>. (KOHAN).

Vendimet e Qeverisë në Luftë Kundër Korrupsionit

Retorika e Qeverisë së Kosovës për luftimin e korrupsionit ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2012. “Tolerancë zero ndaj korrupsionit” është fjalia që e përcjellë kryeministrin Thaçi qysh nga dita e parë e Qeverisë “Thaçi 2”. Mirëpo të kundërtën e vlerësojnë raportet e ndryshme ndërkombëtare dhe vendore.

Matësi i Pulsit, nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, i cili matë besueshmërinë e qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve, tregon se që nga viti 2007 kënaqshmëria ndaj Qeverisë së Kosovës ka rënë dukshëm, respektivisht vetëm 21% e qytetarëve të Kosovës janë të kënaqur me Qeverinë dhe prijësin e saj.² Në po të njëjtin raport vërehet se qytetarët e Kosovës korrupsionin e perceptojnë si faktorin kryesor në ngecjen dhe zhvillimin e Kosovës si shtet. Pikërisht për këtë ata fajësojnë Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante për luftimin e kësaj dukurie.³ Lëvizja FOL edhe përgjatë vitit 2012 ka përcjellë/monitoruar punën e Qeverisë së Kosovës, respektivisht



vendimeve të cilat i nxjerr ky institucion.

Krahasuar me 2011, Qeveria e Kosovës ka treguar regres në nxjerrjen e vendimeve në luftën kundër korrupsionit. Në

² UNDP. (2012). Raporti Puls i Demokracisë. http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/PULSE_ALB_438034.pdf

³ Po aty, fq. 4.

vitin 2011, nga 368 vendime në total 9 kanë qenë në fushën anti-korrupsion, përderisa nga 404 vendime të marra gjatë viti 2012, vetëm 5 hyjnë brenda kuadrit anti-korrupsion.

Nëse shtjellohen këto vendime të marra në kuadër të luftës kundër korrupsion shihet se efekti praktik i tyre nuk do të arrijë ndonjë progres. Në muajin janar, respektivisht me 11 janar 2012, në mbledhjen e dytë të Qeverisë për vitin 2012 aprovohet dokumenti më i lartë shtetëror për luftimin e korrupsionit siç është “Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsion për vitin 2013-2017”. Ky dokument nxjerrët nga Agjencia Kundër Korrupsion, e në parim e nxjerr qeveria si vendim, më pas për ta votuar Kuvendi. Edhe pse si dokument është cilësuar shumë ambicioz nga ana e Agjencisë Kundër Korrupsion dhe nga vetë qeveria e vendit, ajo është kritikuar nga organizatat e shoqërsë Civile për shumë dobësi të shumta.

Vendimi i dytë, të cilin e ka nxjerrë Qeveria për vitin 2012, ka të bëjë me themelimin e Komisionit Ekzekutiv, në të cilën përfshihen Politikat Anti-Korrupsion dhe Gjyqësori. Vendimi i tretë ka të bëjë me

“Kosova nuk ka arritur asnjë rezultat konkret në luftimin e korrupsionit, i cili vazhdon të jetë një problem i madh në procesin e privatizimit, tenderët publikë dhe në ndërmarrjet publike. Qeveria ka ndërhyrë po ashtu në sektorin privat, duke provuar të krijojë monopole në industri të caktuara”. (Freedom House 2012)

kërkesën e Agjencisë Anti Korrupsion për shkarkimin e dy anëtarëve të bordeve - Elez Hajdaraj, anëtar i Bordit të Drejtorëve të KUR “Hidrodrini”, SH.A. Pejë, si dhe z. Ismajl Jonuzi, anëtar i bordit të drejtorëve në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Të dy zyrtarët sipas Agjencisë Kundër Korrupsion kanë paraqitur konflikt interesi.

Qeveria e Kosovës gjatë tre mujorit të dytë të vitit 2012 nuk ka nxjerrë as edhe një vendim, i cili do të ndikonte në uljen, luftimin apo parandalimin e korrupsionit. Pak përparim është bërë gjatë tre

mujorit të tretë të këtij viti, ku nga 97 vendime të nxjerra për muajt korrik, gusht, shtator, 2 nga to janë në interes të korrupsionit. Vendimi i katërt të cilin e ka

“Nevojitet vullnet i lartë politik për ta luftuar korrupsionin. Vullneti i shprehur politik duhet të përkthehet në vepra praktike”.

(Raporti i Fizibilitetit 2012)

nxjerrë Qeveria e Kosovës në fushën kundër korrupsion është ai i miratuar më 7 gusht 2012, e i cili ka të bëjë me “Projektligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale”. Ky projektligj përbën njërin ndër projektligjet që është diskutuar më së shumti, si nga ana institucionale, po aq edhe nga ajo e shoqërisë civile.

Ky projekt-ligj ka hasë në kritika të shumta nga Forumi Këshillues i OJQ-ve për Pakon Ligjore Kundër Korrupsion. Ky Forum në vazhdimësi ka dhënë rekomandime për këtë projektligj, por të cilat rekomandime nuk janë marrë për bazë nga Ministria e Drejtësisë.

Me vendimin e fundit Qeveria ka miratuar dy koncept dokumente: Koncept dokumenti për hartimin e projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë, si dhe koncept dokumenti për hartimin e projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës përgjatë vitit 2012 ka mbajtur gjithsej 47 seanca plenare.⁴ Gjatë këtyre seancave janë miratuar një sërë ligjesh të ndryshme. Ndërkaq në fushën anti-korrupsion nuk është se është punuar mjaftueshëm nga legjislativi i vendit. Infrastruktura anti-korrupsion ende nuk është kompletuar, edhe pse institucionet

⁴ Kuvendi i Kosovës gjatë këtij viti ka mbajtur 47 seanca plenare, 1 të jashtëzakonshme dhe 1 solemne.

relevante që nga viti 2009 kanë filluar me procedimin e ligjeve dhe dokumenteve të kësaj fushe.

Gjatë viti 2012 Kuvendi ka aprovuar dy amendamente në Kodin Penal të Republikës së Kosovës që penalizojnë çështjet e deklarimit të pasurisë dhe të konfliktit të interesit. Me gjithë se kompletimi i pakos ligjore antikorrupsion nuk është se garanton në tërësi luftimin e korrupsionit në vend, ajo paraqet bazën mbi të cilën kjo luftë mund të ofrojë ndonjë efekt. Kuvendi po ashtu ka shqyrtuar në dy seanca të saj plenare Strategjinë dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit, si dhe Ligjin për Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme, dy dokumente tërësisht të kritikuar dhe të pa pranuar nga ana e shoqërisë civile.

Përgjithësisht, Kuvendi ka dështuar që të krijojë dhe mirëmbajë mekanizma të kontrollit të organeve qeveritare dhe nuk ka ofruar kornizë serioze të debatit kundër korrupsionit.

Statistikat e prokurorive në luftë kundër korrupsionit


Hetimi i mangët i rasteve të korrupsionit është njëri ndër problemet më të theksuara të mungesës së luftës kundër korrupsionit. Organet e ndjekjes, me gjithë faktin e një organizimi të brendshëm institucional, caktimi i koordinatorëve anti-korrupsion në prokuroritë e qarkut⁵, nuk kanë arritur të kenë ndonjë efekt të theksuar në luftimin e korrupsionit.

Sipas statistikave të këtij institucioni, për veprat penale të ndërlydhura me fushën anti korrupsion, i bie që në periudhën Janar-Dhjetor 2012 prokuroritë e Kosovës kanë trashëguar nga vitet e mëparshme gjithsej 802 lëndë. Gjatë po kësaj periudhe 1 vjeçare janë pranuar 376 lëndë të reja. Janë ngritur 140 propozim-akuza, 26 aktakuza direkte dhe 106 aktakuza pas hetimit. Rastet e zgjidhura

⁵ Nga viti 2013 sistemi gjyqësor në Kosovë kanë një organizim të ri institucional dhe ndarjes së re të përgjegjëseve. Gjykatat komunale do të transformohen në themelore; gjykatat e qarkut në atw të apelit dhe gjykata supreme e kushtetuese.

sipas numrit të personave janë 770, ndërsa kanë mbetur pa u zgjidhur rreth 990 lëndë.

Në dokumentin e Komisionit Evropian theksohet nevoja për krijimin e një mjedisi të favorshëm për hetime të pavarura dhe profesionale. Ky klasifikim mbi procesin hetimor në përgjithësi tregon në thelb se njëri ndër problemet më të ndjeshme në organin e ndjekjes, por edhe në atë gjyqësor në përgjithësi, është ndërhyrja politike.



Sistemi Gjyqësor


Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme në kuadër të cilitdo sistem politik është pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, apriori parandalon dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

“Kërcënimet dhe shantazhet janë të shpeshta në sistemin gjyqësor dhe ato vazhdojnë të jenë pjesë e vazhdueshme e këtij sistemi”.

(Raporti i Fizibilitetit 2012)

Këshilli Gjyqësor i Kosovës⁶ - Gjykatat e rregullta komunale të Kosovës kanë trashëguar nga vitet paraprake 197 lëndë: 148 nga kategoria Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 30 nga kategoria Marrja e Ryshfetit dhe 19 nga kategoria Dhënia e Ryshfetit. Gjatë gjithë vitit 2012 janë pranuar në punë gjithsej 169 lëndë: 97 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 34 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 38 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit. Ndërkaq si lëndë në punë që janë në proces të shqyrtimit janë gjithsej 366: 245 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 64 në Marrje të Ryshfetit dhe 57 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit. Gjykatat komunale kanë zgjidhur gjithsej 148 lëndë: 96 në kuadër të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare, 21 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 31 në Dhënie të Ryshfetit.

Ndërkaq në fund të periudhës raportuese kanë mbetur gjithsej 218 lëndë të pazgjidhura: 149 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 43 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 26 në Dhënie të Ryshfetit.



⁶ Në kuadër të monitorimit tonë të Gjykatave të rregullta të Republikës së Kosovës I analizojmë vetëm tri kategoritë kryesore që kanë të bëjnë me veprat penale me natyrë korruptive; Shpërdorimi I pozitës zyrtare, marrja e rryshfetit, dhënia e rryshfetit.

Policia e Kosovës

Policia e Kosovës me gjithë se ka riorganizuar kapacitetet e saja administrative, me qëllim të luftimit të korrupsionit, prapëseprapë kjo strukturë mbetet e kufizuar për sa i përket aftësive të saja për të hetuar aktivitetet e ndërlukuara kriminale.⁷

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezultojnë që gjatë viti 2012 janë kryer hetime ndaj 157 personave, 56 janë arrestuar, 129 janë dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, 1 rast është dërguar në prokurori me N/N dhe 19 raste janë dërguar me raport të Prokurorit.



Në Dokumentin Punues të Komisionit Evropian të Studimit të Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, u theksohet se Kosova duhet të fokusohet në përmirësimin e besueshmërisë së statistikave në luftën kundër korrupsionit.⁸

7 Komisioni Evropian - "Dokumentin Punues i Stafit të Komisionit - Komunikata e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës", 10 tetor 2012. http://www.mei-ks.net/repository/docs/Dokumentin_punues_i_Komisionit_Evropian_mbi_SF_per_MSA_mes_BE-se_dhe_Kosoves.pdf

8 Po aty.

Agjencia Kundër Korrupsion

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) është njëri nga mekanizmat institucional të themeluara me ligj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Pjesa kryesore e mandatit të AKK-së, ajo e hetimit preliminar të rasteve të korrupsionit, gjatë vitit që lamë pas nuk mund të pasqyrohet në këtë raport duke qenë se publikimi i këtyre të dhënave bëhet gjatë marsit të viti 2013. Në këtë kontekst, të dhënat statistikore me rastet e hetuara nga AKK-ja nuk janë në dispozicion për publikun.

Megjithatë, AKK-ja gjatë viti 2012 ka qenë e angazhuar në aspekte tjera të përmbushjes së mandatit të saj ligjor. Bazuar në të dhënat e AKK-së, deklarimin e pasurisë, si njëri nga obligimet kryesore ligjore të zyrtarëve të lartë publik, gjatë viti 2012 e kanë përmbushur 3354 apo 91.71% e tyre, ndërsa 261 zyrtarë nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor⁹. Raportet dhe të dhënat e AKK-së mbi deklarimin e pasurisë përgjatë tri viteve të fundit, kur edhe ka nisur publikimi i pasurisë, tregojnë se ka një tendencë në rritje të zyrtarëve që nuk e deklarojnë pasurinë¹⁰. Në vitin 2010, të dhënat e AKK-së tregojnë që nga numri total prej 1483 zyrtarëve që e kanë pasur obligim ligjor deklarimin e pasurisë, 77 prej tyre nuk e kanë përmbushur këtë obligim. Në vitin 2011, nga totali prej 1742 zyrtarëve të obliguar ta deklarojnë pasurinë, 88 prej tyre kanë dështuar ta respektojnë ligjin. Edhe pse përgjatë këtyre tri viteve shihet se numri i zyrtarëve të lartë publik që janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë është rritur, prapëseprapë vërehet se ka një rritje të numrit të atyre zyrtarëve që nuk e respektojnë ligjin.

Kjo tendencë në rritje e mos përfilljes së obligimeve ligjore për deklarim të pasurisë arsyetohet me faktin se normat ligjore që rregullojnë këtë fushë janë të buta dhe nuk paraqesin kërcënim për

9 Agjencia kundër Korrupsionit –AKK- “Përfundon procesi i publikimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë publik”, 13 korrik 2012. <http://ëëë.akk-ks.org/index.php?cid=1,4,522>

10 Agjencia kundër Korrupsionit –AKK - “Rastet e iniciuara për mos deklarim të pasurisë dhe sanksionet”, 12 shtator 2012. <http://akk-ks.org/repository/docs/Analiza.pdf>

këta zyrtarë. Çështja e penalizimit të deklarimit të rrejshëm apo e mos deklarimit të pasurisë nuk kanë qenë të rregulluara me Kodin Penal të Kosovës gjatë vitit 2012. Por me Kodin e ri Penal të Republikës së Kosovës këto dy kategori, deklarimi i rrejshëm dhe refuzimin për deklarimin e pasurisë¹¹, tashmë penalizohen. Ky amandamentim pritet që në praktikë të jap një efekt domethënës në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Domosdoshmëria e penalizimit të deklarimit të rrejshëm apo e mos deklarimit të pasurisë me Kodin e ri Penal është treguar edhe me rastin kur zyrtarët që marrin post të ri zyrtar dhe që po ashtu janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë dështojnë të bëjnë një gjë të tillë. Gjatë viti 2012, nga 253 zyrtarw të lartë publikë 234 apo 92% prej tyre e kanë përmbushur këtë obligim ligjor, ndërsa 19 apo 0.8% nga numri i përgjithshëm nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas emërimit¹².

AKK-ja brenda këtij viti ka shqyrtuar një numër të rasteve të konfliktit të interesit dhe bazuar në të gjeturat edhe ka marrë vendime mbi këto raste¹³. Rasti që ka bërë më së shumti bujë në opinion ka qenë vendimi i AKK-së për ekzistimin e konfliktit të interesit në rastin e drejtorit ekzekutiv të PTK-së, Ejup Qerimi¹⁴. Si asnjë herë më parë, rasti Qerimi kundër AKK ka marrë dimension të një konfrontimit dhe refuzimi të drejtorit ekzekutiv të PTK-së për ta pranuar vendimin e AKK-së mbi ekzistimin e konfliktit të interesit. Deri në konfirmimin final nga Gjykata e Lartë për Kundërvajtje¹⁵, e cila ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në rastin e Ejup Qerimit, ky nuk ka pranuar vendimin e AKK-së për

¹¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës – KPRK - Neni 437 - Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare. Neni 424 - Konflikti i interesit.

¹² Agjencia kundër Korrupsionit –AKK- “Me marrjen e detyrës pasurinë e kanë deklaruar 234 zyrtarë”, 22 nëntor 2012. <http://www.akk-ks.org/index.php?cid=1,4,555>

¹³ Agjencia kundër Korrupsionit –AKK- “ Konflikti i Interesit - Vendimet”. <http://www.akk-ks.org/index.php?cid=1,1170>

¹⁴ Agjencia kundër Korrupsionit –AKK - “Drejtori i PTK-së është në konflikt interesi”, 09 korrik 2012. http://akk-ks.org/repository/docs/0.001_Ejup_Qerimi.pdf

¹⁵ Agjencia kundër Korrupsionit –AKK - “GJLK vërteton aktvendimin e gjykatës për kundërvajtje në Prishtinë në rastin e z Qerimi”, 21 dhjetor 2012. http://akk-ks.org/repository/docs/Gjykata_e_larte.pdf

t'u detyruar më pastaj të jap dorëheqje nga pozita e anëtarit në Bordin e Trustit Pensional të Kosovës. Sidoqoftë, nga viti 2013 me Kodin Penal të Republikës së Kosovës është penalizuar 'konflikti i interesit' dhe si i tillë pretendohet se do të qartësojë dhe përmirësojë këtë komponentë të luftës kundër korrupsionit.

Brenda viti 2012 AKK-ja ka nxjerrë edhe një analizë mbi ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit në Kosovë¹⁶. Kjo analizë, sipas AKK-së, tregon që rastet e korrupsionit në Kosovë kanë një shkallë të ulët si në aspektin e ndjekjes, por edhe në atë të gjyqimit.

Organizatave ndërkombëtare

Raporti i Fizibilitetit - Dokumenti Punues i Stafit të Komisionit Evropian për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës thekson që ka një përmirësim për sa i përket kuadrit ligjor kundër korrupsionit në Kosovë¹⁷. Po ashtu, dokumenti thekson që ka një avancim për sa i përket konsolidimit të mekanizmave institucional kundër korrupsionit. Sipas dokumentit, Agjencia Kundër Korrupsionit, si njëri nga mekanizmat kyç në luftë kundër korrupsionit, tashmë merret me aspekte të parandalimit të konfliktit të interesit dhe deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë publik. Agjencia, po ashtu sipas këtij dokumenti, luan rol edhe në hetimin paraprak të rasteve të dyshuara të korrupsionit dhe në rast të gjetjeve të fakteve është e obliguar të njoftojë autoritetet tjera, të tilla si policinë dhe prokurorinë për hetim të mëtejshëm penal.

Dokumentit thekson që edhe në aspektin e administrativ gjatë këtyre tri viteve të fundit ka një riorganizim, me synim konsolidimin e luftës kundër korrupsionit. Aty përmendet fakti i krijimit të një task forcë anti-

¹⁶ Agjencia kundër Korrupsionit -AKK - "Analizë mbi ndjekjen dhe gjykimin e rasteve korruptive në Kosovë", 6 korrik 2012.

http://akk-ks.org/repository/docs/0.07_Raporti_me_statistikat_2012_versioni_perfundimtar_shqip.pdf

¹⁷ Komisioni Evropian - "Dokumentit Punues i Stafit të Komisionit - Komunikata e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës", 10 tetor 2012. http://ëëë.mei-ks.net/repository/docs/Dokumentit_punues_i_Komisionit_Evropian_mbi_SF_per_MSA_mes_BE-se_dhe_Kosoves.pdf

korrupsion¹⁸ të përbërë nga prokurorë (nga Kosova dhe EULEX-i) dhe hetuesit e policisë me qëllimi hetimin e krimit ekonomik dhe financiar. Po ashtu, aty ceket që edhe njësisia e policisë kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit dhe departamentet e inspektimit janë themeluar në shumë autoritete dhe institucione, me qëllim që të adresohet dhe monitorohet situata në lidhje me korrupsionin dhe/apo sjelljen kriminale brenda vetë organizatës.

Përkundër një përparimi minimal, dokumenti thekson që si në aspektin legjislativ, por edhe në atë institucional të infrastrukturës kundër korrupsionit duhet të punohet më shumë. Dokumenti përmend përmirësimin e kuadrit ligjor mbi parandalimin e konfliktit të interesit, në transparencën e financimit të partive politike, veçanërisht në trajtimin e çështjes së ndalimit apo të rregullimit të rreptë të donacioneve nga subjektet juridike dhe të cilat ofrojnë mallra dhe shërbime për administratën publike. Dokumenti thekson gjithashtu nevojën që partitë politike të kenë një llogari të vetme bankare dhe të përcaktojnë afatet për publikimin e raporteve të tyre financiare.

Duke qenë se dokumenti cekë që aspekti ligjor dhe institucional është në fuqi dhe i konsoliduar, theksi duhet të vendoset tek rezultatet e prekshme. Sipas dokumentit, Kosova duhet të fokusohet në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të korrupsionit dhe të përmirësojë besueshmërinë e statistikave në luftën kundër korrupsionit.

Transparency International - Organizata e vetme që në Kosovë matë perceptimin e korrupsionit është Transparency International - TI. Të dhënat e ofruara nga TI janë të vetmet shifra empirike që ekzistojnë mbi perceptimin e korrupsionit në Kosovë. Në një aspekt, kjo tregon se sa e varfët është skena e të dhënave empirike mbi nivelin e korrupsionit, shtrirjen e tij sektoriale dhe format më të shpeshta të shfaqjes së tij.

Gjatë viti 2012, TI ka ranguar Kosovën në vendin e 105 nga 176 vende gjithsej, dhe me 34 pikë, si e korruptuar nga gjithsej 100 sa

¹⁸ Shefi i Task-Forces Antikorrupsion në Prokurorinë Speciale të Kosovës, Nazmi Mustafi, tashmë nuk është duke e ushtruar funksionin zyrtar duke qenë se është akuzuar për korrupsion dhe gjendet në paraburgim.

konsiderohet maksimalja e pikëve për vendet e pa korruptuara¹⁹. Me gjithë faktin që për dallim nga viti 2011 Kosova ka shënuar ngritje në renditje, nga vendi i 112 dhe me pikë 2.9, prapëseprapë Kosova vazhdon ta ketë nivelin e perceptimit të korrupsionit më të lartin në rajon, përjashtimisht Shqipërisë. Vendet e rajonit, si Serbia për shembull, është renditur e 80 në listë, përderisa Bosnja e 72, dhe e 69 Maqedonia.

Rangimi në vendin e 105 e vendosë Kosovën në një nivel të korrupsionit me vende si Bolivia, Gambia, Algjeria, Armenia, Mali, Meksiko dhe Filipinet. Për më shumë, vetë niveli i pikëve që ka Kosova në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, 34, tregon që Kosova ka probleme serioze me korrupsionin.

Freedom House - Një raport tjetër i rëndësishëm ndërkombëtar që vlerëson nivelin e korrupsionit në botë, duke përfshirë edhe Kosovën, është edhe ai Nations in Transit realizuar nga Freedom House. Bazuar në të gjeturat e këtij raporti rezulton se Kosova nuk ka shënuar aspak progres në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Sipas këtij raporti mungon vullneti politik për t'i zbatuar ligjet anti-korrupsion. Asnjëri nga hetimet nuk ka rezultuar me dënime apo ndëshkime. Më tej, ky raport thekson se Kosova nuk ka arritur asnjë rezultat konkret në luftimin e korrupsionit, i cili vazhdon të jetë një problem i madh në procesin e privatizimit, tenderët publikë dhe në ndërmarrjet publike. Qeveria ka ndërhyrë po ashtu në sektorin privat, duke provuar të krijojë monopole në industri të caktuara. Kosova sipas këtij raporti është vlerësuar me notën 5.75, duke mos shënuar progres në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Raportet nga Organizatat e Shoqërisë Civile

Viti 2012 është treguar se ka pasur një koordinim më të theksuar të punës së organizatave të shoqërisë civile për sa i përket kuadrit

¹⁹ Transparency International - TI- "Corruption Perception Index", 2012. <http://cpi.transparency.org/cpi2012/results/>

ligjor kundër korrupsionit. Tri nga organizatat kryesore që merren me aspekte të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, Lëvizja Fol, Organizata COHU! dhe Instituti Demokratik i Kosovës kanë koordinuar aktivitetet edhe përgjatë viti 2012, ku kanë arritur të bëjnë presion në futjen e dy kategorive juridike në Kodin Penal. Tashmë çështja e ‘deklarimit të rrejshëm’ dhe ‘refuzimit të deklarimit’, por edhe ‘konflikti i interesit’ janë të penalizuara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës²⁰, dhe si të tilla paraqesin një përparim në luftë kundër korrupsionit. Posaçërisht, futja e këtyre tri kategorive juridike në Kodin e ri penal do të ndihmojë në parandalimin e deklarimeve të rrejshme dhe të refuzimit të deklarimit të pasurisë dhe të shmangies së konfliktit të interesit.

Po ashtu, një Forum i përbërë nga dhjetë organizata²¹ joqeveritare gjatë viti 2012 janë marrë edhe me çështjen e rregullimit të fushës së konfiskimit të pasurisë së paligjshme. Përpjekjet e këtyre organizatave nuk kanë rezultuar të suksesshme, duke qenë se ligji i miratuar në shkurt të 2013 nuk ka përfshirë edhe kërkesat kryesore të Forumit. Rekomandimet e Forumit për ligjin e konfiskimit të pasurive të paligjshme kanë qenë:

²⁰ Kodi Penal i Republikës së Kosovës 1. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës. 2. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. 3. Vlera e padeklaruar e pasurisë, të të ardhurave ose të dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë joligjore konfiskohet. **Neni 424 Konflikti i interesit.** 1. Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. 2. Nëse çështja zyrtare është veprim i prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet. 3. Për qëllime të këtij neni, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit për një çështje zyrtare. 153 4. Për qëllime të këtij neni, shprehja “çështje zyrtare” nënkupton procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo personit tjetër. 5. Për qëllime të këtij neni, shprehja “person juridik që ka të bëjë me të” nënkupton personin juridik në të cilin zyrtari apo anëtar i familjes ka marrëdhënie financiare.

²¹ Asociacioni i Kriminalistëve të Kosovës, Organizata COHU, Lëvizja FOL, Instituti GAP, Iniciativa Kosovare për Stabilitet, Iniciativa për Progres, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, Qendra për Politika dhe Avokim, Youth Initiative for Human Rights (YIHR)

1. Duhet ndryshuar emri i draft-ligjit, i cili në të njëjtën kohë reflekton në fushëveprimin dhe qëllimin e këtij draft-ligji.

2. Pasuria e përfiturar në mënyrë të paligjshme të vërtetohet nga i dyshuari, e jo sipas detyrës zyrtare. Me bartjen e barrës së provës tek të dyshuarit, do të rritej mundësia e luftimit më efikas të krimit të organizuar dhe pasurisë së paligjshme. Një përvojë e tillë paraqitet edhe në shtetet e rajonit, si Shqipëria, Sllovenia e Bullgaria.

3. Ky draft-ligj do të duhej të zbatohet edhe për pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme të personave të dyshuar, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra të lejohej retroaktiviteti tij.

4. Sugjerohet krijimi i mekanizmave të veçanta brenda institucioneve ekzistuese (polici, prokurori, gjykata) me qëllim të zbatimit më efikas të legjislacionit të kësaj fushe.²²

Forumi i OJQ-ve po ashtu ka kritikuar edhe draft- Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017. Sipas Forumit, dokumenti i përgatitur nga Agjencia kundër Korrupsionit nuk ofron bazë të qëndrueshme për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Gjykuar sipas Forumit Strategjia dhe Plani i Veprimit kanë zbrazëtira dhe paqartësi të shumta, gjë që do ta bëjnë dokumentin jo efektiv kundrejt korrupsionit.²³

Lëvizja FOL, në një analizë të saj, ka treguar që edhe dokumentet e mëparshme strategjike kundër korrupsionit kanë qenë shumë të mangëta në përmbajtje, por para se gjithash nuk kanë dhënë efekte praktike²⁴.

22 Organizata ÇOHU! – “Ligji për Amnistimin e Pasurive të Paligjshme”, 11 shkurt 2012. <http://ëëë.cohu.org/sq/Aktivitete-i/Ligji-p-r-Amnistimin-e-Pasurive-t-Paligjshme-132>

23 Po aty.

24 Lëvizja FOL – “Strategjia Kundër Korrupsion: Dobësitë e Strategjisë Kundër Korrupsion dhe Planit të Veprimit 2009-2011”.

http://levizjafol.org/images/uploads/files/Hulumtim_Politikash_Dobesite_e_Strategjise_Kunder_Korrupsion_dhe_Plani_i_Veprimit_2009-2011.pdf

Falënderime

Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.lëvizjafol.org

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështesë qytetarin aktive, të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtarë, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.

Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry



Rr. Andrea Gropa, Nr. 35. 10000 Prishtinë, Kosovë

Mob.: +377 (0) 44 131 542 | www.levizjafol.org | info@levizjafol.org